



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

OPINION MBI KANDIDATIN Z. ARTUR CARA

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 Vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 11.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurorit z.Artur Cara, i cili është i caktuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe prej një viti është i komanduar si Këshilltar pranë KLP dhe ka rishfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurori Z.Artur Cara ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2009, pasi me dekretin nr. 6360, datë 10.12.2009 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, ndërkohë që më parë ka punuar si Oficer i Policisë Gjyqësore. Ai ka një eksperiencë profesionale në punë si Prokuror prej më shumë se 10 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, aktualisht është i komanduar prej 1 viti si Këshilltar pranë Këshillit dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr. 1507/1 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier rezulton se nisur nga ngarkesa në punë në këtë Prokurori, komandimi i tij pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk dëmton interesat aktuale të Prokurorisë së Fierit.

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i z. Artur Cara në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nuk passjell cenim të interesave të larta të Prokurorisë së Fierit dhe nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Vijimin e procedurave të komandimit për kandidatin prokuror për Z.Artur Cara.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Datë: 24.02.2020